

## SHENIMET SHPJEGUESE

### **1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqeria “A&A PHARMA ” sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 03/09/2012 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Mbi Shoqërите Tregtare”.

Shoqëria është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane me NIPT L22103004V . Selia e shoqërisë është në Autostrada Tr-Dr, Km.4, Kashar( ne ambientet e shoqerise AQUILA GROUP ), Tirane  
Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 aksione me vlerë nominale 100,000 LEK i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 leke.

### **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

#### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standarde Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

#### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqites**

Këto pasqyra financiare janë paraqitura në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### **2.5. Vlerësimet dhe gjykime**

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimet dhe supozimet që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimet e aktiveve e detyrimet të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimet dhe gjykimet në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 2.5.2. Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siq paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitura e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 siq kërcohët nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

### 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95

USD/ LEK

107.82

111.10

### 3.2. Instrumentat finansiarë

Instrumentat finansiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat finansiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi i që lidhet me to, përvç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaktionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat finansiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finansiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përsitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaktionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

#### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për tu arkëtuar, detyrimeve për tu paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktivë.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.4. Aktive afatgjata materiale

#### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë

jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

#### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### 3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rrugullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvëç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të

ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

### 3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesni njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesni mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatimi fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 eshte 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### 3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjisacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

### 3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 3.11. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe përisqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

### 3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

### Bilanci kontabel, aktivet

#### 4. Aktive monetare

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2018 eshte ne shumen 21,865,160 leke si me poshtë:

Nr	Likujditete	Viti 2018	Viti 2017
1	Banke	316,627	1,819,802
2	Arka	21,548,533	11,939,902
	<b>Totali</b>	<b><u>21,865,160</u></b>	<b><u>13,759,704</u></b>

Gjendja e likujditeteve, detyrimet dhe kërkesat ndaj te treteve ne monedhe te huaj gjendje ne 31.12.2018 jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2018 te Bankes se Shqiperise dhe diferençat jane marre ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 5. Te drejta te arketushme

Paraqitet gjendja e kërkesave te pa arketuara me 31.12.2018 ne shumen 5,722,097 leke.

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2018	Viti 2017
1	Nga aktiviteti i shfrytezimit	5,332,769	7,272,641
2	Te tjera	389,328	629,055
3	Parapagime te dhena	0	0
	<b>Totali</b>	<b><u>5,722,097</u></b>	<b><u>7,901,696</u></b>

##### 5.1 Nga aktiviteti i shfrytezimit

Paraqitet shuma prej 5,351,287 leke, e cila paraqet kërkesen ndaj klienteve , te paraketuar deri ne daten 31.12.2018.

##### 5.2 Te tjera

Paraqitet shuma prej 389,328 leke me 31.12.2018 e cila paraqet kërkesen per shumen e TVSH per tju marre shtetit 75,264 dhe per shumen e Tatim Fitimit per tju marre shtetit 314,064.

## 6 Inventaret

Gjendja e inventarit, Lende te para, me 31.12.2018 eshte 8,079,485 leke, si me poshte :

Nr	Inventaret	Viti 2018	Viti 2017
1	Lendet e para	1,963,432	1,888,642
2	Mallra	6,116,053	5,570,737
	<b>Totali</b>	<b>8,079,485</b>	<b>7,459,379</b>

- ❖ Vleresimi i mallrave ne momentin e blerjes eshte bere me koston e hyrjes veprimet e daljes e te gjendjeve te inventarit jane bere me kosto mesatare e cila nuk ka ndryshuar ne vite.
- ❖ Te gjitha transaksionet e kryera si blerje, shitje, kalim ne llogarite e shpenzimeve vjetore i perkasin ushtrimit kontabel te vitit 2018.

## 7 Aktive afat gjata materiale

Gjendja e aktiveve afat gjata eshte paraqitur me vleren kontabel te mbetur, vlere fillestare minus amortizimin e mbartur, e cila me 31.12.2018 eshte 216,369 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Toka dhe ndërtesa	0	0
2	Mjete transporti	119,466	149,333
3	Makineri e pajisje	70,000	87,500
4	Pajisje zyre dhe informatike	26,903	33,628
	<b>Totali</b>	<b>216,369</b>	<b>270,461</b>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017.

## Bilanci kontabel, pasivet.

## 8 Detyrimet Afatshkurtra

Ne kete post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2018 ne shumen 32,525,141 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2018	Viti 2017
1	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	0	0
2	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	32,373,692	26,195,680
3	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	125,267	101,775
4	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	26,182	21,840
5	<i>Të pagueshme te tjera</i>	0	0
	<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>32,525,141</b>	<b>26,319,295</b>

### 8.2 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Ne kete post jane te perfshira detyrimet e shoqerise ndaj furnitoreve ne 31.12.2018 ne shumen 32,373,692 leke

**8.3 Të pagueshme per sigurime shoqerore**

Ne kete post jane te perfshira detyrimet e shoqerise per sigurime shoqerore e shendetesore ne shumen 114,336 dhe detyrimet per pagat ne shumen 10,931 me 31.12.2018.

**8.4 Të pagueshme për detyrimet tatimore**

Detyrimet tatimore paraqiten ne shumen 26,182 leke dhe jane te detajuara si me poshte.

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2018	Viti 2017
1	Tatimi mbi te ardhurat personale	26,182	21,840
2	Tatim mbi vleren e shtuar	0	0
3	Tatim fitimi sipas bilancit	0	0
4	Tatim ne burim	0	0
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b><u>26,182</u></b>	<b><u>21,840</u></b>

**9 Kapitali**

Kapitalet e veta jane ne shumen 3'357'970 leke. Kapitali i vet eshte rritur me fitimin e vitit ushtrimor per 286,025 leke. Te detajuara jane ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Kapitali I regjistruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Divident	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2018	100,000	0	0	0	2,971,945	3,071,945
2	Shtesat per 2016	0	0	0	0	286,025	286,025
3	Paksimet per 2016	-	-	0	0	0	0
4	<b>Gjendja me 31.12.2016</b>	<b><u>100,000</u></b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b><u>3,257,970</u></b>	<b><u>3,357,970</u></b>

**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve****10 Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit**

Gjate vitit 2018 shoqeria ka realizuar te ardhura nga aktiviteti ne shumen 31,782,252 leke, si me poshte:

Nr	Pershkrimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	31,782,252	27,061,128
	<b>Shuma</b>	<b><u>31,782,252</u></b>	<b><u>27,061,128</u></b>

**11 Te ardhura te tjera te shfrytezimit**

Gjate vitit 2018 shoqeria ka realizuar te ardhura nga aktiviteti ne shumen 0 leke.

## 12 Lendet e para dhe materialet e konsumueshme

Ne kete ze jane te perfshira materialet e konsumuara te vitit 2018 ne shumen 23,943,337 si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Blerje materiale	24,563,443	22,025,078
2	Ndryshimi i gjendjes	-620,106	-1,726,754
	<b>Shuma I</b>	<b>23,943,337</b>	<b>20,298,324</b>
Nr	Te tjera shpenzime		
1	Sherbime nga te trete	0	0
	<b>Shuma II</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Shuma e materialeve te konsumuara</b>	<b>23,943,337</b>	<b>20,298,324</b>

## 13 Kosto e punes

Totali i kostos se punes per vitin 2018 eshte 6,441,838 leke.

Nr	Kosto e Punes	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime per paga	5,04,828	4,486,818
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	837,010	623,300
	<b>Shuma</b>	<b>6,441,838</b>	<b>5,110,118</b>

## 14 Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Ne kete ze jane perfshire amortizimet e aktiveve afat gjata materiale per vitin 2018 ne shumen 54,092 leke.

Nr	Pershkrimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Amortizimi i pajisje informatike	6,726	6,382
2	Amortizimi i mjeteve te transportit	29,867	37,333
3	Amortizimi makineri dhe pajisje	17,500	0
	<b>Shuma</b>	<b>54,092</b>	<b>43,715</b>

**15 Shpenzimet e tjera shfrytesimi**

Ne kete ze jane perfshire shpenzime te tjera ne shumen 971,910 leke, per vitin 2018, te cilat jane detajuar si me poshte :

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
2	Qira	600,000	600,000
3	Mirembajtje dhe riparime	11,750	38,217
4	Sigurime	18,300	18,300
5	Te tjera	40,791	105,945
6	Shpz.postare e telekom.	33,626	0
7	Transporte per blerje	37,819	0
8	Tatim mbi qark. dhe akciza	9,312	19,920
9	TAN	66,463	29,801
10	Taksa dhe tarifa vendore	101,000	101,000
11	Tatime te tjera	22,930	15,430
12	TAKSE SKANIMI	6,481	19,061
13	Shpenzime te tjera	22,200	6,200
14	Gjoba dhe demshperblime	1,237	
	<b>Shuma</b>	<b><u>971'910</u></b>	<b><u>953,874</u></b>

**16 Te ardhurat te tjera**

Paraqiten te ardhura ne shumen 7,040 leke dhe perfaqeson te ardhurta e analizuar me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga demshperblimet	7,040	0
2	Fitimenga kurset e kembimit	0	196,980
3	Te ardhura nga interesat (hua)	0	0
4	Te ardhura nga zbritja e furnitorit	0	0
	<b>Shuma</b>	<b><u>7,040</u></b>	<b><u>196,980</u></b>

**17 Shpenzime financiare**

Paraqitet në shumën 37,100 lekë dhe përfaqëson shumën e shpenzimeve nga interesi dhe humbjet nga kureset e këmbimit për vitin 2018.

Nr	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Humbje nga kursi i këmbimit	644	0
2	Shpenzime për interesa bankare	36,456	46,103
	<b>Shuma</b>	<b><u>37,100</u></b>	<b><u>46,103</u></b>

## 18 Llogaritja e rezultatit tatimor

Nr	EMERTIMI	VITI 2018	VITI 2017
1	Të ardhura	31,789,292	27,260,608
2	Shpenzime	-31,448,276	-26,452,134
3	<b>Rezultati</b>	<b><u>341,016</u></b>	<b><u>808,474</u></b>
4	<b>Shpenzime te pazbritshme</b>	<b><u>25,587</u></b>	<b><u>0</u></b>
	a) Gjoba e penaliteve	1,237	0
	d) Paga te likujduara me arke	24,350	0
5	<b>Fitimi I tatushem</b>	<b><u>366,603</u></b>	<b><u>808,474</u></b>
6	Tatimi I fitimit	-54,990	-121,271
7	<b>Fitimi neto</b>	<b><u>286,026</u></b>	<b><u>687,203</u></b>

Per vitin ushtrimor 2018 shoqeria paraqitet me një fitim neto prej 286,026 leke.

## 19 Angazhime dhe pasiguri

### Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2018 Shoqeria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

## 20 Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyrave financiare.

Hartuesi i Pasqyrave



Klodian Doda

# A&A PHARMA sh.p.k

Superstrada Tr-Dr, Km 4, Tirane  
NIPT L22103004V

Tirane me 1 Mars 2019

## KONTRATE SHERBIMI

Lidhur sot midis :

Shoqerise “A&A PHARMA” shpk me nr. NIPTI : L22103004V, adrese: Superstrada TR-DR, km.4, Kashar, Tirane me administrator **Z. Edmond Ziso**.

Dhe

**Znj. Klodita Mino**, me Nr ID I56120019A , me profesion Financiere, banuese ne Tirane ,

Palet bien dakord se Znj. Klodita Mino do te pergatise dhe do te hartoje te gjitha Pasqyrat Finaciare te vitit 2018 per llogari te shoqerise A&A PHARMA shpk .

Shoqeria A&A PHARMA sh.p.k do te paguaje per sherbimin qe do te kryhet nga Znj. Klodita Mino shumen prej 30'000 Lek .

Per shoqerine ‘ A&A PHARMA ‘ shpk

Administratori  
Edmond Ziso

*Eduard Ziso*  
*Edmond Ziso*



**Znj. Klodita Mino**

*Klodita Mino*  
*Z*